

Statuti i Partisë



10 shkurt 2018 - PRISHTINË

STATUTI I PARTISË ALTERNATIVA

Përmbatja:

| | |
|---|-------------------------------------|
| DISPOZITAT E PËRGJITHSHME - Neni 1 | 4 |
| EMËRTIMI I PARTISË DHE AKRONIMI - Neni 2..... | 4 |
| SELIA, SIMBOLI, FLAMURI DHE VULA - Neni 3 | 4 |
| NJOHJA E SUBJEKTIVITET JURIDIK - Neni 4..... | 5 |
| SHTRIRJA TERRITORIALE - Neni 5 | 5 |
| QËLLIMI DHE PARIMET KRYESORE TË PARTISË - Neni 6 | 5 |
| VIZIONI - Neni 7 | 5 |
| AKTET NORMATIVE - Neni 8 | 6 |
| KOHËZGJATJA - Neni 9..... | 7 |
| ANËTARSIMI, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË NË PARTI - Neni 10..... | 7 |
| AKTIVITETI JASHTË KOSOVËS - Neni 11 | 7 |
| ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI - Neni 12..... | 7 |
| KUVENDI I PARTISË - Neni 13..... | 8 |
| KUVENDI I JASHTËZAKONSHËM - Neni 14 | 9 |
| KËSHILLI I PËRGJITHSHËM - Neni 15..... | 9 |
| KRYESIA E ALTERNATIVËS - Neni 16..... | 10 |
| KRYETARI I ALTERNATIVËS - Neni 17 | 9 |
| NËNKRYETARI I - Neni 18..... | 11 |
| SEKRETARI - Neni 19..... | 11 |
| | Error! Bookmark not defined. |
| KUVENDI I DEGËS - Neni 20..... | 11 |
| | Error! Bookmark not defined. |
| DETYRAT E KRYETARIT TË DEGËS - Neni 21 | 12. |

STATUTI I PARTISË ALTERNATIVA

| | | |
|---|----|-------------------------------------|
| NËNDEGA - Neni 22 | 12 | Error! Bookmark not defined. |
| DEGËT E ALTERNATIVËS JASHTË KOSOVËS - Neni 23..... | 13 | Error! Bookmark not defined. |
| FORUMI I GRUAS - Neni 24..... | 13 | |
| FORUMI I RINISË - NENI 25..... | 14 | |
| KOMISIONET - Neni 26..... | | Error! Bookmark not defined. |
| KOMISIONI I ETIKËS - Neni 27 | 15 | |
| KOMISIONI FINANCIAR - Neni 28 | 15 | Error! Bookmark not defined. |
| FORMIMI I KOMISIONEVE - Neni 29..... | 15 | |
| KËSHILLAT E EKSPERTËVE - Neni 30..... | | Error! Bookmark not defined. |
| FINANCIMI DHE RAPORTIMI-Neni 31 | 16 | |
| PUNA DHE DETYRAT E DREJTUESIT FINANCIAR - Neni 32 | 16 | |
| AUDITIMI - Neni 33..... | | Error! Bookmark not defined. |
| SHTABI ZGJEDHOR - Neni 34 | 17 | |
| VOTA, VOTIMI DHE VENDOSJA - Neni 35 | | Error! Bookmark not defined. |
| MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN - Neni 36..... | 18 | |
| SANKSIONET - Neni 37..... | 18 | Error! Bookmark not defined. |
| MASAT NDËSHKUESE - Neni 38 | 18 | |
| DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE - Neni 39..... | 18 | |
| MIRATIMI I KRYESUESES - | 19 | |

Në bazë të Ligjit Nr. -3/L – 73 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr. -3/L – 256 për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit për Zgjedhjet, Ligjit Nr. -3/L – 72 për Zgjedhjet Lokale dhe të Ligjit Nr. -3/L – 174 për Financimin e Subjekteve Politike, Kuvendi i Partisë Alternativa, i mbajtur me 10 / 02 / 2018 miratoi këtë:

Statut

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1.1. Alternativa është parti politike me orientim Liberal-Demokratik. Alternativa synon realizimin e programit të saj politik konform me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

EMËRTIMI I PARTISË DHE AKRONIMI

Neni 2

- 2.1** Emërtimi i plotë i partisë është **Alternativa**.
- 2.2.** Akronimi i partisë është **ALTERNATIVA**
- 2.3** ALTERNATIVA ka logon dhe simbolet e saj.
- 2.4.** ALTERNATIVA është subjekt juridik.

SELIA, SIMBOLI, FLAMURI DHE VULA

Neni 3

- 3.1.** Selia e partisë është në Prishtinë, **Rr. “UÇK” Kompleksi Qafa, Kati 1, nr.67, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.**
- 3.2.** ALTERNATIVA e ka simbolin e vet identifikues. Simboli i Partisë përbëhet nga shkronja A me ngjyrë të artë. Ky simbol përdoret nga organet përfaqësuese të ALTERNATIVËS ose me autorizim të tyre.
- 3.3.** Flamuri i Partisë është me ngjyrë të kaltër në qendër të të cilit ndodhet simboli me ngjyrë të artë, si dhe me sfond të bardhë dhe simboli me ngjyrë të artë në qendër.

3.4. Vula e ALTERNATIVA-s do të ketë formën e rrumbullakët. ALTERNATIVA do të ketë vulën kryesore e cila do të përdoret nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Sekretari Organizativ si dhe çdo degë do të ketë vulën e vet të ngjashme me vulën kryesore por do të identifikohet në bazë të numrit rendor dhe emrit të degës. Përmbajtja e logos së ALTERNATIVA-s do të jetë e përfshirë edhe në vulë.

NJOHJA E SUBJEKTIVITET JURIDIK

Neni 4

4.1. ALTERNATIVA e fiton subjektivitetin juridik pas miratimit të programit politik dhe statutit, dhe regjistrimit në evidencën e partive politike në Republikën e Kosovës.

SHTRIRJA TERRITORIALE

Neni 5

5.1. ALTERNATIVA do të veprojë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe jashtë në pajtim me dispozitat ligjore të vendeve ku do të ketë shtrirje ajo.

QËLLIMI DHE PARIMET KRYESORE TË PARTISË

Neni 6

6.1. Alternativa do të veprojë në interes të të gjithë qytetarëve të Kosovës, në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave qytetare dhe politike.

6.2. Alternativa synon zhvillimin ekonomik të bazuar në ekonominë e tregut të lire.

6.3. Alternativa do t'i adresojë problemet sociale dhe kulturore të qytetarëve të Kosovës, të luftojë në mënyrë demokratike dhe në pajtim me ligjin kundër çdo lloj forme të diskriminimit.

6.4. Alternativa synon integrimin e Republikës së Kosovës si anëtare të denjë në Bashkimin Evropian, NATO dhe organizatat tjera shumëkombëshe që mbështesin vlerat demokratike.

6.5. Alternativa është parti e themeluar në bazë të të gjitha parimeve demokratike që ka për qëllim të ushtrojë veprimtarinë e saj demokratike në nivel qendror dhe lokal, si një parti e pavarur. Është parti e hapur në bashkëpunim me të gjitha partitë tjera të Kosovës, në pajtim me sistemin e së drejtës dhe të gjitha mjetet dhe parimet tjera demokratike.

6.6. Liria e zgjedhjes dhe respektimi i votës së lirë janë parime bazë të garantuara nga Alternativa.

6.7. Alternativa mbronë të drejtën e mendimit të lirë dhe të drejtën e fjalës. Partia do të promovojë masa të barabarta për çdo individ të moshës madhore që pranon statutin dhe programin e saj politik.

6.8. Alternativa bazohet në marrjen e vendimeve të mbështetura në fakte dhe prova. Ne mbështetemi

në hulumtime legjitime dhe ekspertizë për të marrë vendime racionale dhe të informuara për të siguruar qytetarët tanë me një qeveri të përgjegjshme që adreson nevojat e tyre.

6.9. Alternativa do të qeverisë bazuar në vlerat e etikës dhe integritetit, duke zbatuar standardet më të larta të sjelljes në përfaqësim të përgjegjshëm të qytetarëve të Kosovës.

VIZIONI

Neni 7

7.1. Alternativa do të angazhohet në kthimin e besimit në vlerat e demokracisë dhe përgjegjësinë ndaj vullnetit të qytetarëve. Alternativa synon të ketë shoqërinë në të cilën pushtetet janë qartazi të ndara në mes të qeverisjes dhe sundimit të ligjit si pjesë e shoqërisë së hapur, me mbrojtje të barabartë të drejtave të njeriut, drejtave të shoqërisë, liritë qytetare dhe liritë politike për të gjithë njerëzit padallim.

7.2. Alternativa promovon të drejtat dhe liritë themelore të parapara në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Konventën Ndërkombëtare mbi të drejtat Civile dhe Politike, Konventën Ndërkombëtare të Drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe konventave të tjera ndërkombëtare dhe regjionale me karakter të tillë si dhe të ngjashme në pajtim me ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

7.3. Alternativa beson se procesi i shtetndërtimit të Kosovës do të përfundojë suksesshëm vetëm me krijimin e konsensusit politik dhe shoqëror për integrimin e shtetit tonë në komunitetin ndërkombëtar.

7.4. Alternativa respekton dhe promovon diversitetin etnik, kulturor, religjioz etj, si pasuri kombëtare e Kosovës. Alternativa do të angazhohet për arritjen e barazisë së mundësive për të gjithë personat, më theks të veçantë në grupet shoqërore të personave me aftësi të kufizuara.

7.5. Alternativa do të bashkëpunojë me organizata dhe parti politike, në nivel rajonal dhe më gjerë, të cilat kanë program të ngjashëm dhe pranojnë parimet themelore të Alternativës.

7.6. Alternativa do të punojë për integrimin evropian të Republikës së Kosovës në organizata dhe mekanizma që i shërbejnë interesave të të gjithë qytetarëve dhe që promovojnë vlerat liberal-demokratike.

7.7. Alternativa do të ndihmojë, fuqizojë dhe inkurajojë gratë dhe të rinjtë të avancohen në pozita të ndryshme ekzekutive dhe politike në institucionet e Republikës së Kosovës, shoqërisë civile dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare.

7.8. Alternativa do të punojë dhe bashkëpunojë me organizata tjera simotra politike brenda dhe jashtë Kosovës me orientime të demokracisë liberale.

7.9. Alternativa do të synojë anëtarësimin në asociacione të ndryshme ndërkombëtare me orientime të demokracisë liberale.

7.10. Alternativa do të mbrojë dhe kultivojë lirinë e besimit për të gjitha organizmat fetar në pajtim me ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

7.10. Alternativa do të angazhohet në krijimin e një strukture të fuqishme avokuese / lobuese në botë për promovimin e vlerave të Kosovës.

AKTET NORMATIVE

Neni 8

- 8.1.** Akti më i lartë i partisë është statuti i cili duhet të jetë në pajtim me kushtetutën dhe të gjitha ligjet tjera të Republikës së Kosovës.
- 8.2.** Aktet tjera juridike, pas statudit, janë:
- 8.3.** Rregulloret,
- 8.4.** Vendimet,
- 8.5.** Udhëzimet.

KOHËZGJATJA

Neni 9

- 9.1.** Alternativa parasheh veprimtari në kohëzgjatje të përhershme.

ANËTARSIMI, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË NË PARTI

Neni 10

- 10.1.** Anëtar/e i/e partisë mund të bëhet çdo person i/e cili/a ka mbushur 18 vjet dhe e pranon programin dhe statutin e ALTERNATIVËS.
- 10.2.** Anëtarësimi bëhet përmes nënshkrimit të një deklarate me shkrim në mënyrë individuale në degët dhe nëndegët e ALTERNATIVËS.
- 10.3.** I / E anëtarësuar / a duhet të pajiset me librezën e anëtarësisë së ALTERNATIVËS.
- 10.4.** Anëtar/e i/e ALTERNATIVËS nuk mund të jetë edhe anëtar i ndonjë partie tjetër. Anëtari i partisë ka të drejtë pjesëmarrjeje aktive në organizimin, përcaktimin dhe zbatimin e politikës së partisë në format e parapara me këtë statut dhe në pajtim me të gjitha aktet tjera ligjore dhe nënligjore.
- 10.5.** Secili anëtar ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e partisë apo / edhe të kandidohet për zgjedhje në listat e ALTERNATIVËS.
- 10.6.** Nëse anëtari i ALTERNATIVËS e ndërron degën ose nëndegën për adresën e re do të regjistrohet në degën / nëndegën e vendbanimit të ri.
- 10.7.** Anëtari i ALTERNATIVËS është përgjegjës për respektim të statudit dhe akteve të tjera juridike.
- 10.8.** Alternativa mbanë evidencë për anëtarët dhe mbështetësit e partisë.

AKTIVITETI JASHTË KOSOVËS

Neni 11

- 11.1.** Alternativa organizohet dhe vepron edhe jashtë territorit të Kosovës në përputhshmëri me ligjet e shtetit përkatës.
- 11.2.** Anëtarët e Alternativës jashtë vendit mund të organizohen në degët e diasporës.

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 12

12.1. Organet e partisë janë:

- a) Kuvendi i Partisë,
- b) Këshilli i Përgjithshëm,
- c) Kryesia Qendrore,
- d) Forumin e Gruas,
- e) Forumin e të Rinjve
- f) Kuvendi Degëve
- g) Kryesitë e degëve,
- h) Kryesitë e nëndegëve,
- i) Komisionet dhe grupet e ekspertëve.

KUVENDI I PARTISË

Neni 13

13.1. Kuvendi është organi më i lartë vendimarrës i partisë.

13.2. Numri i delegatëve për Kuvendin e Partisë caktohet me vendim të Kryesisë së Partisë, në afatin 30 (tridhjetë) ditë para Kuvendit.

13.3. Kuvendin e përbëjnë delegatët e zgjedhur në Kuvendet e degëve dhe delegatët të ftuar nga Kryesia e Partisë.

13.4. Përgjegjësit e Kuvendit janë;

- a) Analizon punën e Alternatives për periudhën në mes dy kuvendeve dhe përcakton orientimet kryesore.
- b) Miraton, ndryshon dhe plotëson statutin dhe programin e Alternatives.
- c) Zgjedhë dhe shkarkon Kryetarin e Alternatives.
- d) Zgjedhë dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Drejtues të Alternatives.
- e) Zgjedhë Kryesin e punës dhe
- d) Formon komisionet e nevojshme për mbarëvajtjen e punës së Kuvendit.

13.5. Kuvendi i Alternatives i mbanë takimet e punës të paktën një (1) herë ne vitë dhe Kuvendin Zgjedhorë cdo katër (4) vite.

13.6. Kuvendi i rregulltë i Alternativës thirret nga Kryesia.

13.7. Kryesia është përgjegjëse edhe për;

- a) Përgaditjen e Kuvendit
- b) Rendin e ditës dhe
- c) Mbarëvajtjen e punës në tërësi.

13.8. Delegatët e Kuvendit zgjedhin anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm me vota të fshehta, ndërsa lista e kandidatëve përpilohet me propozimin e të pranishmëve për secilin pozicion propozohen së paku dy (2) kandidatë, për kandidatë mund të propozohen edhe kandidatët që për arsye objektive nuk janë të pranishëm në Kuvend.

- 13.7.** Këshilli i Përgjithshëm i ka 51 (pesëdhjetë e një) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi, kurse anëtarë të këshillit janë edhe kryetarët e degëve, deputetët dhe ministrat (sipas detyrës zyrtare),
- 13.8.** Kuvendi zgjedhë edhe kryetarin e partisë, kandidatët për kryetarë mund të vetkandidohen ose edhe të propozohen nga Kuvendi, kandidatët duhet te garojnë me programet e tyre dhe në mesin e së paku dy (2) kandidatëve, kuvendi me vota të fshehta zgjedhë kryetarin, nëse ka më shumë kandidatë atëherë kryetarë zgjedhet kandidati që i merrë më shumë se 50% të votave.
- 13.9.** Anetarët e kryesisë së partisë zgjedhen nga Këshilli i përgjithshëm, 1/3 e kandidatëve propozohen nga kryetari i partise dhe pjesa tjetër propozohet nga këshilli, për secilën pozite kandidohen së paku 2 (dy) kandidatë, prej tyre (të kandiduarëve) ata të cilët marrin më së shumti vota automatikisht zgjedhen 2 (dy) nënkryetarë, ndërsa të tjerët janë anëtarë të kryesisë.
- 13.10.** Kryesia i ka 17 (shtatëmbëdhjetë) anëtarë, 15 (pesëmbëdhjetë) zgjedhen në Zgjedhjet e përgjithshme, kurse 2 (dy) janë përfaqesues të Forumit të Gruas 1 (një) dhe 1 (një) te Forumit Rinor.
- 13.11.** Sekretari organizativ zgjedhet nga kryesia e partisë.
- 13.12.** Degët aktive të Alternatives që veprojnë në mërgatë, përfaqësohen me nga dy (2) anëtare në Kuvendin e Përgjithshëm.

KUVENDI I JASHTËZAKONSHËM

Neni 14

- 14.1.** Kuvendi i jashtëzakonshëm i ALTERNATIVËS thirret:
- 14.2.** Në rast të shkeljeve të rënda statutore ose programore nga ana e udhëheqësve të ALTERNATIVËS
- 14.3.** Në rast të shpalljeve të zgjedhjeve të jashtëzakonshme.
- 14.4.** Kuvendin e Jashtëzakonshëm mund ta thërras Këshilli Drejtues me kërkesën e 1/3 të anëtarëve të vetë.
- 14.5.** Inicimit të 1/3 të anëtarëve të këshillit duhet të aprovohet nga këshilli me shumicë votash

KËSHILLI I PËRGJITHSHËM

Neni 15

- 15.1.** Këshilli i Përgjithshëm është organi më i lartë ndërmjet dy kuvendeve.
- 15.2.** Përkujdeset për realizimin e detyrave të përcaktuara në kuvendet përkatëse.
- 15.3.** Shqyrton dhe miraton raportet financiare të Alternativës.
- 15.4.** Shqyrton dhe vendos për ndonjë koalicion të mundshëm më ndonjë parti tjetër para dhe pas zgjedhjeve nacionale dhe lokale.
- 15.5.** Nxjerrë rregullore, vendime dhe raporte periodike.
- 15.6.** Këshilli mban mbledhje vetëm nëse marin pjesë 50% +1 të anëtarëve të Këshillit.

15.7. Vendimet në Këshillin e Përgjithshëm merren me shumicën e thjeshtë.

15.8. Këshilli i përgjithshëm drejtohet nga kryetari i partisë.

KRYESIA E ALTERNATIVËS

Neni 16

16.1. Kryesia e Alternativës përbëhet nga: Kryetari, 2 (dy) nënkryetarë, Sekretari organizativ dhe anëtarët e kryesisë, (17 anëtarë, 15 nga Kuvendi, 1 nga Forumi i Gruas, 1 nga Forumi Rinor).

16.2. Mbledhjet e kryesisë mbahen të paktën dy (2) herë në muaj.

16.3. Mbledhjet i thërret kryetari përmes formës më shkrim në afat kohor prej tri (3) ditëve para datës së paraparë të mbajtjes.

16.4. Mbledhjet e kryesisë mund të mbahen nëse të pranishëm janë më së paku prej 50%+1 të anëtarëve.

16.5. Është e drejtë e kryesisë që për trajtimin e problematikave të veqanta që në takim pune të ftojë edhe anëtarë tjerë të partisë pa marrë parasysh nivelin e veprimit.

KRYETARI I ALTERNATIVËS

Neni 17

17.1. Detyrat e kryetarit të Alternativës;

a) Përfaqëson partinë në pajtim me statutin dhe programin.

b) E udhëheq punën e partisë dhe të organeve të saj.

c) Thërret dhe e hap mbledhjen e kuvendit të partisë.

d) Për punën e saj i përgjigjet kuvendit dhe këshillit drejtues.

e) Emëron këshilltarët e vet në rast nevojë.

f) Propozon mbikqyrësit financiarë ndërsa miratimin i mbikqyrësve financiarë bëhet nga kryesia.

g) Propozon shefin e shtabit zgjedhorë.

h) Propozon dhe nënshkruan marrëveshjet politike për koalicion dhe memorandume bashkëpunimi, propozimet e kryetarit miratohen nga Këshilli drejtues.

i) Në rast dorëheqje ose pamundëise fizike për të ushtruar detyrën, kryetarin e zavendëson njëri nga nënkryetarët por jo me gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë.

j) Udhëheq, zbaton përfaqëson dhe realizon vendimet e të gjitha organeve tjera të partisë.

k) Koordinon të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me strukturat e partisë (degë, keshëllin e përgjithshëm, forume, grupe ekspertësh komisione dhe organizime tjera).

l) Në bazë të raportimeve të komisionit statutorë dhe komisionit të etikës, mund të iniciojë masa disiplinore kundër individëve, nëndegëve dhe degëve, iniciimet disiplinore miratohen nga kryesia

e partisë.

17.2. Kryetari zgjedhet nga kuvendi i Alternativës me mandate 4 (katër) vjeqare më të drejtë rizgjedhje vetëm një herë.

17.3. Në rast të mos përmbajtjes së programit dhe statutit, kuvendi ka të drejtë ta shkarkojë kryetarin e partisë Alternativa para skadimit të mandatit.

NËNKRYETARI

Neni 18

18.1. Në mungesën e kryetarit, nënkryetarët e partisë e zavëndesojnë dhe e përfaqesojnë partinë në të gjitha instancet.

18.2. Përfaqësojn zbatimin e politikës dhe të gjitha programet tjera partiake sipas propozimit të kryetarit.

Sekretari

Neni 19

19.1. Përcjellë punën e kryesisë së partisë së Alternativa në marrjen e vendimeve.

19.2. Krijon kushtet për mbarëvajtjen e punës së kryesisë.

19.3. Kujdeset për zbatimin e statutit dhe programit.

19.4. I raporton kryesisë dhe këshillit drejtues, sipas nevojës, për punën dhe aktivitetet e degëve të Alternatives.

19.5. Menaxhon dhe raporton për punën e komisioneve të formuara nga kryesia e partisë.

Kuvendi i Degës

Neni 20

20.1. Kuvendi i degës mbledhet të paktën 1 (një) herë në vitë, në kuvend pune, një herë në 4 (katër) vite në kuvend zgjedhorë si dhe në raste të jashtëzakonshme.

20.2. Kuvendin e degës e formojnë të deleguarit e nëndegëve.

20.3. Numrin e delegatëve në kuvend e cakton kryesia e partisë 30 (tridhjetë) ditë para shpalljes së zgjedhjeve të përgjithshme.

20.4. Kuvendi i degës zgjedh-shkarkon kryesinë dhe kryetarin e degës si dhe zgjedhë delegatët për kuvendin e partisë.

20.5. Kryesia e degës përbëhet nga 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë, 13 (trembëdhjetë) zgjedhën nga kuvendi kurse dy janë përfaqësues të Gruas dhe Forumit Rinor (dy forumet i dërgojnë kryetarët e tyre).

20.6. Anëtarët e kryesisë janë;

- a) Kryetari
- b) Dy nënkryetarë,
- c) Sekretari

d) Dhe anëtarët e kryesisë.

20.7. Anëtarët e kryesisë janë edhe asambleistët komunal të zgjedhur në zgjedhjet e fundit.

20.8. Kuvendi me vota të fshehta zgjedhë kryetarin e degës, në mesin e së paku 2 (dy) kandidatëve.

20.9. Kuvendi zgjedhe anëtarët e kryesisë, duke proceduar si në vijm;

Kryetari i sapozgjedhur propozon 1/3 e kandidatëve, të tjerët propozohen nga kuvendi, për një pozitë së paku 2 (dy) kandidatë, 2 (dy) personat që mbledhin më së shumti vota emërohen automatikisht nënkryetarë dege.

20.10. Sekretari i degës zgjedhet nga kryesia e degës.

20.11. Kryesia e degës i jep raport kuvendit për punën dhe aktivitetin e vet.

20.12. Kryesia e degës mbledhet sipas dinamikës së punës por së paku 1 (një) herë në muaj.

20.13. Kryesia e degës mund të ftoj ne takimet e veta edhe ndonjë anëtarë të degës (nëse ka ndonjë interes të veçant) por pa drejtë vote.

20.14. Kryesia e degës duhet të informoj, kryesin e partisë për shtrirjen e saj, për dinamikën e veprimeve si dhe për problemet, rrespektimin e stautit dhe në realizimin e politikave të partisë.

20.15. Raportimet duhet të realizohen në baza mujore dhe sipas kërkesës së kryesisë së partisë.

20.16. Qdo degë duhet të ketë rregullore të brendshme të punës në pajtim me statutin e partisë.

Detyrat e kryetarit të deges

Neni 21

21.1. Detyrat e kryetarit të degës janë sic vijojnë:

a) Merret me kuvendin e degës.

b) Thërret dhe udhëheq mbledhjet e kryesisë së degës.

c) Kujdeset për zbatimin e vendimeve të kuvendit të degës.

d) Emëron udhëheqësit .ë fushave të ndryshme në aktivitete e Alternativës.

e) Bashkërendon punët më nëndegët.

g) Kryen edhe punët e tjera të cilat dalin nga organet më të larta të Alternatives.

Nëndega

Neni 22

22.1. Nëndega është njësi themelore e organizimit të Alternativës.

22.2. Nëndegët e Alternatives formohen në nivel të lagjeve urbane, vendbanimeve dhe fshatërave.

22.3. Organet udhëheqëse të nëndegës janë:

a) Kryesia e nëndegës.

b) Kryetari i nëndegës.

22.4. Kuvendi i nëndegës duhet ti ketë së paku 21 (njëzet e një) anëtarë (nëse kryesia nuk vendos ndryshe).

22.5. Detyrat e kuvendit të nëndegës janë:

a) Zgjedhë delegatët për kuvendin e degës.

b) Zgjedhë-shkarkon kryesinë e nëndegës dhe kryetarin e nëndegës.

22.6. Kryesia përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë.

22.7. Kuvendi me vota të fshehta zgjedhë kryesinë, në mesin e kandidatëve që i propozon kuvendi i nëndegës, kandidati që merr më së shumti vota zgjedhet kryetarë, kursë 4 (katër) të tjerët më të votuarit zgjedhen anëtarë të kryesisë.

22.8. Takimet e nëndegëve mbahen sipas nevojës, por jo më pakë se 1 (një) herë ne muaj.

22.9. Kryetari ka për obligim që ti zbaton vendimet e degës dhe të raporton për punën e nëndegës në kryesinë e degës.

22.10. Kryesia e nëndegës kryen edhe detyra tjera që kanë të bëjnë me shtrirjen e veprimit, koordinimin me nëndegët tjera si dhe detyra tjera që kërkohen në zbatimin e statutit dhe politikës së partisë.

DEGËT E ALTERNATIVËS JASHTË KOSOVËS

Neni 23

23.1. Alternativa në pajtim me këtë statut dhe ligjet tjera në fuqi, shtrihet me degët e saja ku jetojnë shtetasit Kosovar.

23.2. Përfaqësuesit e këtyre degëve të mërgimtarëve emërohen anëtar të kryesisë (një anëtar për secilën degë).

23.3. Për territorin e veprimit të degës vendos kryesia e bashkësisë së degëve dhe kryesia e ALTERNATIVËS.

23.4. Degët në mërgim veprojnë , sipas dispozitave të parapara në këtë statut dhe në përputhje me rregulloren e punës.

23.5. Dega dhe nëndegët tjera, koordinohen sipas rregullores së punës dhe kryesisë së partisë.

FORUMI I GRUAS

Neni 24

24.1. Në organet përfaqësuese të zgjedhura të ALTERNATIVËS siç janë kuvendet dhe këshillat drejtues (në të gjitha nivelet e organizimit), gratë marrin pjesë me së paku 30%.

24.2. Komisioni statutar e mbikëqyr realizimin e paragrafit 1 të këtij neni.

24.3. Kuvendi zgjedhor i forumit të gruas mbahet një herë në kater vjet. Ndërsa kuvendi i jashtëzakonshëm mbahet sipas nevojës.

24.4. Organi udhëheqës quhet - Organi i forumit të gruas- OFG.

24.5. OFG synon:

- Fuqizimin e gruas në vendimmarrje,
- Fuqizimin e gruas në punë,
- Fuqizimi i gruas në politikë.

24.6. Krytarja e OFG-së është përgjegjëse për punën e OFG-së, zbatimin e rregullores së punës dhe programin e punës së OFG-së në pajtim dhe koordinim të statutit dhe akteve të tjera të brendshme të partisë.

24.6. OFG organizohet si nivel dege dhe në nivelin qendror.

24.7. Kuvendet e OFG mbledhen në kohën e njëjtë kur mbahen edhe zgjedhjet e rregullta.

24.8. Kuvendi i degës duhet ti ketë së paku 21 (njëzet e një) anëtarë (nëse kryesia e partisë nuk vendos ndryshe).

24.9. Kuvendi zgjedhë kryetarën dhe nënkryetarën e OFG- së.

24.10. OFG e degës zgjedhë delegatet për kuvendin e OFG- së, në nivel qendror.

24.11. Kuvendi i OFG- së, në nivel qendror duhet ti ketë së paku 51 (pesëdhjetë e një) delegatë (nëse kryesia e partisë nuk vendos ndryshe).

24.12. Kuvendi i OFG- së zgjedh kryetarën dhe kryesinë. Zgjedhjet janë të fshehta dhe për secilën pozitë kandidohen së paku 2 (dy) kandidat.

24.13. Kryesia përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë: kryetarja, nënkryetarja, sekretarja si dhe 6 (gjashtë) anëtarë.

24.14. Kryetarja e kryesisë së OFG- së, është anëtare e kryesisë së partisë.

FORUMI I RINISË

NENI 25

25.1. Misioni i forumit të rinisë është që të sensibilizoj rininë që të jetë pjesë e angazhimeve të Alternativës. Në antërsimin e rinisë nuk ka përkufizime moshore.

25.2. Forumi i rinisë organizohet dhe funksionon sipas normave (organizimi, struktura, përfaqësimi, zgjedhjet) të përcaktuara për OFG- në, në bazë të neneve të lartë cekura.

Komisionet

Neni 26

26.1. Komisioni statutor kujdeset për zbatimin e statutit dhe vendimeve tjera të organeve.

26.2. Përbëhet prej së paku 3 (tre) anëtarëve (njohës të mirë të Statutit)

26.3. Komisionet formohen me propozimet e sekretarit organizativ dhe me miratimin e Kryesisë së Partisë.

- 26.4.** Përbërja e komisionit caktohet në bazë të problematikës dhe nivelit organizativ të lëndës.
- 26.5.** Anëtarët e komisionit duhet të veprojnë drejtë dhe të deklarohen nëse në trajtimin e lëndës mund të kenë konflikt interesi.
- 26.6.** Për punën e vet komisioni duhet të përpiloj raport dhe të propozoj masat.
- 26.7.** Raporti ju dorëzohet sekretarit i cili pastaj e prezanton në kryesi.

Komisioni i Etikës

Neni 27

- 27.1. Për rastet kur anëtarët e partisë në veprimin e tyre reflektojnë mos rrespekt ndaj vlerave morale, etike, kulturore, etnike, religjioze, gjinor dhe të lirive themelore. Anëtarët dhe simpantizantët e partisë mund të kerkojnë veprime konkrete nga komisioni i etikës.
- 27.2. Komisioni i etikës vepron sipas kritereve dhe metodologjisë së punës të percaktuar për komisionin statutorë.

Komisioni Financiarë

Neni 28

- 28.1.** Propozimet për emrimin e komisionit financiar e paraqet sekretari organizativ të cilët miratohen nga kryesia e ALTERNATIVËS.
- 28.2.** Komisioni financiar perbehet nga 3 anëtarë.
- 28.3.** Mandati i komisionit zgjatë aq sa zgjatë mandati i kryetarit.
- 28.4.** Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit financiar përcaktohet me rregullore të veçantë.
- 28.5.** Mënyra e kompenzimi dhe mbrendshem te Alternatives caktohet me nje vendim the veqante dhe nxjerr nga kryesia e Alternatives dhe aprovuar nga këshilli i përgjithshëm.

Neni 29

- 29.1.** Me qëllim të realizimit të misionit, programit dhe vendimive të Alternatives, kryesia e partisë mund të formojë edhe komisione tjera me mandate të përkohshme.

Këshillat e ekspertëve

Neni 30

- 30.1.** Këshillet / grupet e ekspertëve zgjidhen nga kryesia e ALTERNATIVËS.
- 30.2.** Këshilli / grupi i ekspertëve zgjidhet për një mandat 4 vjeçar me mundësi rizgjedhjeje.
- 35.2.** Këshilli / grupi i ekspertëve Është organ këshillëdhënës i partisë, përcjell, analizon, harton projekte, studion politikat dhe të gjitha aktet ligjore me rëndësi për jetën shoqërore, ekonomike, politike, sociale, kulturore, arsimore, shkencore, shëndetësore, të mbrojtjes dhe të sigurisë dhe të sportit në Kosovë.

30.4. Përcakton projekt-propozime, për ndryshime dhe plotësime të aktiviteteve të caktuara Brenda partisë të parapara sipas të gjitha akteve të brendshme të partisë.

FINANCIMI DHE RAPORTIMI

Neni 31

- 31.1.** ALTERNATIVA financohet nga mjetet e mblendhura nga anëtarësia e Alternatives ,
- 31.2.** Nga buxheti i Republikës së Kosovës sipas ligjislacionit në fuqi
- 31.3.** Nga donacionet nga donatorë të ndryshëm.
- 31.4.** Raportet financiare gjashtëmujore dhe vjetore të mjeteve të arkëtuara dhe mjeteve të shpenzuara, do të behen transparente konform legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës per raportim financiar .
- 31.5.** Raporti përfundimtar për financimin miratohet nga këshilli i përgjithshëm

PUNA DHE DETYRAT E DREJTUESIT FINANCIAR

Neni 32

- 32.1.** Drejtuesi i financave përgjigjet për mjetet e deponuara në xhirollogaritë bankare.
- 32.3.** Të drejtë në përdorimin e xhirollogarisë bankare kanë: Drejtuesi i financave dhe dy financier të tjerë të autorizuar të cilët janë të sistemuar nëpër degë të ALTERNATIVËS.
- 32.4.** Drejtuesi i financave e benë menaxhimin e buxhetit të pronës dhe të pasurisë së ALTERNATIVËS dhe të ndarjes së burimeve financiare nëpër degë.
- 32.5.** Drejtuesi i financave ia paraqet kryesisë raportet dhe projektet mujore dhe raportet tre mujore financiare.
- 32.6.** Anëtarësia e partisë mbildhet në degë dhe nëndegë. Ndarja dhe shpenzimi i mjeteve bëhet me rregullore të posaçme të cilat i miraton Këshilli drejtues.
- 32.7** Zyrtarët e financave në aspektin organizativ janë pjesë e zyrës së sekretarit, kurse shpenzimet i raportojn në kryesi.
- 32.8.** Drejtuesi i financave është i autorizuar të nënshkruaj për çështje financiare në emër të partisë. Arkatari ka për obligim që punën e tij ta kryej në harmoni me ligjet në fuqi.
- 32.8.** Në rast të shpërbërjes së partisë së ALTERNATIVËS, Kuvendi i ALTERNATIVËS i cili merr vendim për shpërbërje, njëkohësisht merr vendim për shpërbërjen e fondeve të mjeteve të saj.Fondet dhe mjetet e partisë i dhurohen ndonjëres nga shoqatat humanitare që kanë selinë dhe veprojnë në Kosovë.

AUDITIMI

Neni 33

- 33.1.** Përbërjen e komisionit për auditor e miraton kryesia e ALTERNATIVËS me propozim të kryetarit.
- 33.2.** Komisioni përbëhet nga 3 ekspertë të fushës.
- 33.3.** Komisioni e kontrollon veprimtarinë e financave dhe të kontabilitetit ku shtrihet partia me degët e saj brenda dhe jashtë vendit.
- 33.4.** Auditimi mund të bëhet edhe nga kompani jashtë partisë sipas nevojës.
- 33.5.** Tërheqjet dhe deponimet duhet të bëhen në llogari bankare së paku me dy (2) nënshkrime.
- 33.6.** Shpenzimet me para në dorë nuk duhet të kalojnë shumën mbi 90 euro brenda 24 orë, ku çdo pagesë mbi këtë shumë duhet nënshkruar nga dy persona të autorizuar.
- 33.7.** Të gjitha pagesat me vlerë mbi 99 euro duhet të jenë kryer me transfere bankare.

SHTABI ZGJEDHOR

Neni 34

- 34.1.** Krijohet me propozim të kryetarit dhe me vendim të këshillit drejtues të partisë së ALTERNATIVËS.
- 34.2.** Numri i anëtarëve të shtabit zgjedhor të partisë do të jetë 7 duke u udhëhequr nga njëri prej tyre, autorizimet dhe obligimet e shtabit zgjedhor.
- 34.3.** Mandati i shtabit zgjedhor është konform me vendimin e paragrafit një të këtij neni.

VOTA, VOTIMI DHE VENDOSJA

Neni 35

- 35.1.** Anëtari i ALTERNATIVËS ka të drejtë në një votë.
- 35.2.** Forma e votimit në organin përkatës të ALTERNATIVËS zbatohet në pajtim me statutin dhe aktet tjera nënligjore.
- 35.3.** Kuorumi për vendosje në ALTERNATIVË ekziston kur për aktin e propozuar voton së paku 50%+1 (gjysma plus një) e të gjithë anëtarëve të organit përkatës

MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Neni 36

- 36.1.** Kryesia e ALTERNATIVA do të emëroj zëdhënësin.

Sanksionet

Neni 37

37.1. Për mos rrepektimin e statutit dhe politikave programore të Alternativës, kryesia e partisë mund të shqiptoj këto sanksione:

- a) Vërejtje me gojë.
- b) Vërejtje me shkrim.
- c) Parapërdjashtim.
- d) Përdjashtim nga partia.
- e) Anulim të zgjedhjeve.
- f) Shuarja e nëndegëve dhe degëve.
- g) Kërkesa për zgjedhje të jashtëzakonshme dhe masa tjera të propozuara nga komisionet e Alternativës.

Masat ndëshkuese

Neni 38

38.1. Masat ndëshkuese apo sanksionet shqiptohen nga kryesia e partisë pas procedurave hetimore të komisioneve.

38.2. Kryesia e partisë për sanksionet e ndërmara duhet të informojë këshillin e partisë.

Dispozitat përfundimtare

Neni 39

39.1. Zgjedhjet për OFG (Organizatës për forumin e gruas) dhe forumin Rinorë duhet të mbahet me krijimin e kushtve optimale pas kuvendit të përgjithshëm zgjedhorë, kryetarët e zgjedhur me automatizëm bëhen pjesë e strukturave të dalura nga zgjedhjet e fundit.

39.2. Përfaqësimi i gruas (jo më pak se 30%) duhet të sigurohet në të gjitha organet e partisë.

39.3. Për mënyren dhe formen e plotësimit të organeve të partisë, në bazë të spacificave të krijuara, vendos kryesia e partisë.

39.4. Plotësimet në organet e Alternativës mund të bëhen me votim të fshehtë me 50%+1 (pesëdhjetë plus një) të anëtarëve të organit përkatës.

39.5. Për zbatimin e politikave të partisë kryesia e partisë nxjerrë:

- a) Vendime
- b) Rregullore
- c) Udhëzime dhe akte tjera nënligjore (të gjitha në përputhsmëri me statutin)

- 39.6.** Shpjegime për zbatimin e dispozitave të këtij statuti i jep komisioni statutor.
- 39.7.** Organet dhe strukturat e degëve të dalura nga zgjedhjet e fundit nuk ndryshojnë deri në zgjedhjet e radhës.
- 39.8.** Ky statut hynë në fuqi pas përfundimit të punës së kuvendit zgjedhorë.

Datë: 10.02.2018

MIMOZA KUSARI – LILA
